



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 41 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 2216 të datës 27.10.2022 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS **për plotësimin e vendit të lirë të punës**

1. Pozita:	Zyrtar për softuer dhe harduer
Numri i referencës:	ZSH/ZKA/22-10/22
Grada:	ZKA-C4
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq të gjitha projektet që ndërlidhen me infrastrukturën e harduerëve dhe softuerëve, duke përfshirë projektimet teknike, zbatimin e proceseve të tjera teknike dhe konfigurimi i tyre;
- Siguron përkrahje të softuer-it për aplikacionet standarde dhe ofron përkrahje për sistemet operative;
- Analiza dhe hartimi i specifikave për përmirësime të mëtutjeshme të sistemeve harduerike dhe softuerike sipas kërkesave teknike dhe nevojave të organizatës;
- Bashkëpunimi i ngushtë me administratorët nga stafi i IT për të siguruar se sistemet janë funksionale dhe të sigurta gjatë tërë kohës;
- Instaloni, montoni dhe konfiguroni kompjuterët, monitorët, telefonat, infrastrukturën e rrjetit dhe periferiket si printerët, skanerët.
- Zgjidh problemet në sistemin e kompjuterëve, duke përfshirë problemet e harduer-it, e-mail, problemet e pajisjeve të rrjetit dhe pajisjeve periferike, riparoni dhe korrigjoni problemet e paraqitura;
- Bashkëpunoni me zyrtarin për administrimin e rrjetit për konfigurimin, mirëmbajtjen dhe migrimin e serverëve;
- Veproni si burim teknik duke i ndihmuar shfrytëzuesit për t'i zgjidhur problemet me pajisje dhe në të dhëna;
- Kryeni edhe detyra të tjera sipas kërkesës nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së Informacionit.

Shkathësitë e kërkua:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e zhvillimit dhe administrimit të teknologjisë së Informacionit;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme lidhur me teknologjinë e Informacionit;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Njohuri të mira të menaxhimit të projekteve dhe të vlerësimit të ndikimit të projekteve
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet).
- Njohuri të mira të gjuhës angleze.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 17.11.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.